



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr. 15/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit “Matkos Group HC Sharri” SH.P.K., me NUI:810857758, me seli në Shtërpçë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Betim Shala., avokat nga Prishtina, kundër debitorit Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut “KOSTT” SH.A., me NUI:811284512, me seli në Prishtinë, rruga “Isa Boletini” nr.39, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.368/23 të datës 31.08.2023, me datë 04.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut “KOSTT” SH.A., ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.368/23 të datës 31.08.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.368/23 të datës 31.08.2023, në dispozitivin e aktvendimit e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit “operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut “KOSTT” SH.A., i ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.305/23 të datës 14.02.2023, të Përmbartuesit Privat Irfan I. Kërçagu.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.368/23 të datës 31.08.2023.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka kërkuar nga Gjykata e Shkallës së Dytë që të refuzoj në tërësi si të pabazuar ankesën e debitorit ndërsa aktvendimin e Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.368/23 të datës 31.08.2023, ta lë në fuqi.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Matkos Group HC Sharri” SH.P.K., me dt. 14.02.2023, ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit të besueshëm, - Faturës nr.03/22 të datës 31.07.2022, Faturës nr.04/22 të datës 31.08.2022, Faturës nr.05/22 të datës 30.09.2022, Faturës nr.06/22 të datës 31.10.2022, Faturës nr.07/22 të datës 30.11.2022, duke urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrit, t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 257,542.44 €, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e rënies në vonesë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, në të kundërtën të bllokohen llogaritë bankare të debitorit ose përmbartimi të realizohet përmes regjistrimit, konfiskimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, deri në pagesën e borxhit. Debitori në prapësimin e paraqitur, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për përmbartim duke theksuar se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbartimor nuk mund të konsiderohen si provë e besueshme, sepse nuk përmbajnë elementet e dokumentit – faturës që konsiderohet e besueshme sipas ligjit. Tutje ka shtuar se, kreditori në asnjë rrethanë nuk ka vërtetuar se të njëjtat janë nënshkruar dhe pranuar nga debitori, e që do të ishte përmbushur kushti i domosdoshëm për të qenë dokument i përshtatshëm për përmbartim në pajtim me Ligjin për Procedurën Përmbartimore dhe se debitori nuk ka të lidhur marrëveshje me kreditorin për Blerje të Energjisë për Kapacitete Gjeneruese nga Burime të Ripërtëritshme, pasi që kreditori është shoqëri tjetër nga shoqëria me të cilën debitori ka marrëveshje. Po ashtu ka theksuar se faturat e dorëzuara debitori i ka refuzuar, duke i kthyer mbrapa fizikisht. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit, lënda të prishet si dhe të anulohen veprimet e ndërmarra.

Kreditori në përgjigje në prapësimin e debitorit, i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit duke theksuar se debitori në prapësim ka pranuar faktin se i kanë pranuar faturat, por se të njëjtat i ka kthyer me arsyetimin se nuk ka pasur obligim për pagesë. Ka theksuar se pretendimi i debitorit se nuk ka asnjë marrëveshje të lidhur me kreditorin për blerje të Energjisë për Kapacitete Gjeneruese nga Burime të Ripërtëritshme, është i pabazuar për faktin se nga prova e bashkangjitur në propozim, përkatësisht Marrëveshja nr.1134 e datës 10.11.2017, vërtetohet se debitori ka të lidhur marrëveshje me kreditorin “Matkos Group HC Sharri” SH.P.K, duke shtuar se kreditori gjatë tërë kësaj periudhe kohore ka prodhuar dhe liferuar energjinë elektrike dhe debitori pa asnjë vërejtje e ka pranuar dhe shitur në tregun e lirë. Në fund, Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit dhe pas mbajtjes së seancës dëgjimore të datës 17.08.2023, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.368/23 të datës 31.08.2023, ku në dispozitivin e aktvendimit e ka refuzuar në tërësi si të

pa bazuar prapësimin e debitorit “Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut “KOSTT” SH.A., i ushtruar kundër Urdhrit Përmbarrimor P.nr.305/23 të datës 14.02.2023, të Përmbarruesit Privat Irfan I. Kërçagu.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se faturat në bazë të të cilave është lejuar urdhri për përmbarrim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjkata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarrimi është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori, e të cilat fatura përmbajnë elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”.

Po ashtu, faturat kontestuese janë pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori të cilat vërtetohen nga vula e pranimit të fletkthesës së postës andaj, gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjkata shqyrtoi pretendimin ankimor sa i përket legjitimitetit të kreditorit në këtë procedurë përmbarrimore mirëpo gjykata bazohet në përmbajtjen e dokumentit në bazë të cilit iniciohet dhe zhvillohet procedura përmbarrimore, andaj, në këtë rast propozimi për përmbarrim është paraqitur nga kreditori Matkos Group HC Sharri SH.P.K., me numër unik identifikues 810857758, i cili figuron si kreditore edhe në dokumentet e besueshme - faturat të cilat janë objekt shqyrtimi në këtë procedurë përmbarrimore. Përndryshe në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.15/24 me datë 04.06.2024

Gjyqtari
Faton Bajrami